

RREGULLORE NR. 2000/35

NDRYSHIMI I RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2000/2 MBI AKCIZAT NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1, të ndryshuar, të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/2 të datës 22 janar 2000 mbi Akcizat në Kosovë dhe Rregullores nr. 2000/26 të UNMIK-ut me të cilën ndryshohet Rregullorja 2000/2 e UNMIK-ut e datës 27 prill 2000,

Derisa neni 2.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/2, e ndryshuar, parashikon se mallrat të cilat i nënshtrohen akcizave dhe tarifave në fuqi të akcizave janë parashtruar nga Aneksi A,

Me qëllim të ndryshimit të Aneksit A të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/2, të ndryshuar,

Shpall sa vijon:

Neni 1
Ndryshim

Aneksi A i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/2, e ndryshuar, do të zëvendësohet nga Aneksi A i kësaj Rregulloreje për të shtuar automobilët dhe automjetet motorike.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 16 qershor 2000.

Bernard Kouchner,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

ANEKSI A

MALLRAT QË I NËNSHTROHEN AKCIZAVE DHE TARIFAT E ZBATUESHME

PËRSHKRIMI I MALLIT	SHIFRA NË SISTEM TË HARMONIZUAR	TARIFA E TAKSËS
Kafja	0901	30% të vlerës
Pijet joalkoolike	2202	10% të vlerës
Birra	2203	20% të vlerës
Verërat	2204; 2205; 2206	20% të vlerës
Etil alkooli	2207	50% të vlerës
Alkool, liker dhe pijet e tjera alkoolike	2208	50% të vlerës
Cigaret, cigaret puro, cigarillos	2402	25% të vlerës
Prodhimet e tjera të përpunuara të duhanit	2403	25% të vlerës
Gazolina	2710001110; 1120; 1190	50% të vlerës
Nafta për automjete (D1 + D2)	2710003100	50% të vlerës
Vaji i ngrohjes	2710004100; 2710004900	50% të vlerës
Vajguri	2710001900; 2110; 2190	50% të vlerës
Telefonat mobilë	851719	15% të vlerës
Videot	8521	15% të vlerës
Aparatet televizive	8528	15% të vlerës
Antenat satelitore	85291031	15% të vlerës
Automobilët dhe automjetet, kryesisht të disejuara për transportin e personave (pos atyre që hyjnë në radhën nr. 8702), duke përfshirë automobilët e tipit karavan dhe automobilët e garave	8703	20% +1000 DM secili